



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1838/Prot.

Tiranë, më 28. 07.2025

VENDIM

Nr. 186, Datë 16.07.2025

“PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS SË KANDIDATES PËR MAGJISTRAT PROKUROR, E CILA ËSHTË DIPLOMUAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS NË VITIN AKADEMIK 2024 - 2025, ZNJ. ELIDA GRABOVARI”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen plenare të datës 16.07.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatës për magjistrat prokuror, e cila është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024 - 2025, znj. Elida Grabovari”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1938, datë 09.07.2025, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, pasi dëgjoi relatorin Erind Merkuri si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,



V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, Këshilli) garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve.
2. Me Vendimin Nr. 24, datë. 13.02.2025, "*Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për magistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magistraturës në vitin 2025*", Këshilli ka filluar procedurën administrative për verifikimin e pasurisë dhe figurës për 26 (njëzet e gjashtë) kandidatë prokurorë të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magistraturës, në vitin 2025, ndër të cilët edhe kandidatja Elida Grabovari.
3. Me Vendimin nr.25, datë 13.02.2025, për "*Hedhjen e shortit dhe caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për 26 (njëzet e gjashtë) kandidatët për magistratë prokurorë, të cilët mund të diplomohen nga Shkolla e Magistraturës në vitin akademik 2025*", Këshilli zhvilloi procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit, për secilin kandidat.
4. Relatori për kandidaten Elida Grabovari, z. Erind Merkuri në zbatim të Pikës 1, të Seksionit A, të Kreut VI, të Rregullores, në rrugë elektronike (me e-mail) me datë 17.02.2025 ka njoftuar kandidaten për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar i Këshillit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.
5. Në përgjigje, me e-mail-in e datës 18.02.2025, kandidatja Elida Grabovari ka konfirmuar marrjen e e-mail-it të mësipërm, si dhe faktin që nuk ndodhet në situatën e konfliktit të interesit me Relatorin.
6. Në datë 21.05.2025, Relatori i ka dërguar me e-mail kandidates formularët përkatës dhe autorizimin, me qëllim verifikimin nga ana e Këshillit të të dhënave që lidhen me pasurinë dhe figurën.
7. Në datë 25.02.2025, kandidatja Elida Grabovari ka depozituar në protokollin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentet, si më poshtë vijon:
 - i. *Autorizimi për Këshillin e Lartë të Prokurorisë me qëllim sigurimin dhe verifikimin e të dhënave personale;*
 - ii. *Deklaratë me të dhënat mbi adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike për njoftim gjatë kësaj procedure;*
 - iii. *Deklaratë mbi papajtueshmërinë me funksionin e magistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike;*
 - iv. *Deklaratë Individuale që kandidatja nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete;*
 - v. *Formular Vetë-deklarimi për zbatimin e Ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".*

8. Në mbështetje të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, germës “b”, të Kreut II, dhe Seksionit B, të Kreut VI, të Rregullores, Relatori ka ndjekur veprimet procedurale për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidates Elida Grabovari.
9. Pas verifikimeve paraprake dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet përgjegjëse shtetërore, Relatori ka paraqitur para Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Relacionin me gjetjet paraprake për kandidaten për t’u emëruar magjistrat (profili Prokuror), për znj. Elida Grabovari.

A. VERIFIKIMI I PASURISË SË KANDIDATES

10. Me shkresën Nr.353 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), për njoftimin për verifikimin e pasurisë për kandidaten për magjistrate, e cila do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2025.
11. Me shkresën Nr.765 prot., datë 11.03.2025, Këshilli i është drejtuar ILDKPKI, për verifikimin e pasurisë për kandidaten për magjistrate, e cila do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2025.
12. Nga ana e këtij institucioni, është kthyer përgjigje me shkresën Nr. 87/23 prot., datë 24.04.2025. ILDKPKI ka paraqitur aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidates për pozicione të ndryshme në sistemin e drejtësisë, për kandidaten për magjistrate, e cila do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës, znj. Elida Grabovari.
13. Në këtë akt përfundimtar për subjektin deklarues znj. Elida Grabovari theksohet, se: nga ILDKPKI është dërguar pranë Këshillit, Akti i kontrollit të plotë për Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidates për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë për Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës Nr. 811/25 prot., datë 06.10.2022.
14. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe Ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është konstatuar se, për kandidaten Elida Grabovari, është përfshirë periudha e kontrollit deri në datë 29.06.2022 dhe konkretisht si më poshtë vijon;
- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Nisur nga konstatimi i mësipërm nga institucioni i ILDKPKI, Anëtari/Relator Z. Erind Mercuri në mbledhjen e datës 26.06.2025 të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale ka vënë në dukje këtë konstatim dhe me miratimin e dy anëtarëve të tjerë të Komisionit ka kërkuar të vihen në dispozicion të gjitha aktet shkresore lidhur me kandidaten Elida Grabovari të vitit 2022 nga zyra e protokoll-arkivës pranë Këshillit.
16. Gjatë verifikimeve të akteve shkresorë ka rezultuar se, anëtari/relatori Z. Erind Mercuri me e-mailin e datës 31.10.2022 ka njoftuar subjektin e kontrollit znj. Elida Grabovari me gjetjet dhe i ka vënë në dispozicion një kopje të Aktit të kontrollit të ILDKPKI-së.
17. Gjithashtu, bazuar në germën "b", të pikës 12, të Seksionit A, të Kreut IX, të Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019 "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve, Relatori në datën 31.10.2022, ka kërkuar me e-mail nga kandidatja Elida Grabovari, që të depozitojë pranë zyrës së protokollit të Këshillit ose të përcjell të skanuara me e-mail, brenda 5 ditëve shpjegimet me shkrim si dhe dokumentacion mbështetës plotësues ose sqarues.
18. **Kandidatja në datë 04.11.2022 dorëzoi pranë zyrës së protokollit në KLP shpjegimet në lidhje me konstatimin e ILDKPKI, ku na sqaron si vijon:**
- Për sa më sipër, nga ana e ILDKPKI parashtrohet se: **Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.**
Vlerësoj se ky konstatim vjen në interpretim të gabuar të ligjit dhe provave të dorëzuara nga ana ime apo të administruara nga vetë ILDKPKI.
Sjell në vëmendje se nga ana e b/shortit është deklaruar në pronësi të tij, njësi 40 m² në qytetin e Vlorës.
Në datë 12.04.2000 për këtë njësi është lidhur kontratë qiraje midis b/shortit dhe qiradhënësit z. Bujar Roçaj. Nëpërmjet kësaj kontrate, përcaktohet se z. Bujar Roçaj do të zhvillonte pranë kësaj njësie aktivitetin tregtar, do të përmbushte çdo detyrim ndaj të tretëve dhe do të paguante qiranë në vlerën 25.000 lekë në muaj.
Bujar Roçaj figuron si subjekt i regjistruar tregtar me NIPT K36331207E.
Në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 33, përcaktohet se: Tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet në ambientet e marra me qira, duhet të deklarojnë, llogarisin, mbajnë dhe derdhin për llogari të organeve tatimore tatimin në burim (tatimin mbi qiranë).
Në interpretim të kësaj dispozite, detyrimin ligjor për deklarimin, llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen për llogari të organeve tatimore tatimin mbi qiranë, e ka patur tatimpaguesi Bujar Roçaj me NIPT K63331207E.
Detyrimi kontraktual i përcaktuar, ka qenë i njëjtë dhe i pandryshuar përgjatë të gjithë periudhës që ka qëndruar në fuqi nga viti 2000 deri në vitin 2020 të evidentuara nga ana e ILDKPKI.

Në asnjë moment ligji procedural tatimor nuk ngarkon b/shortin në cilësinë e pronarit të njësisë të dhënë me qira, për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi qiranë pranë organit tatimor.

Në faqen ëeb të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve¹, administrata tatimore i drejtohet qytetarëve që lëshojnë prona me qira duke patur për qëllim njohjen e ligjit dhe informon:

Çdo individ ka të drejtë të shfrytëzojë asetet që zotëron për të përfituar të ardhura në formë të ligjshme.

Në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenet 8 dhe 9, këto të ardhura janë të tatueshme në shkallë tatimore 15%.

- i. Në rastin kur pronën tuaj i’a keni dhënë me qira një subjekti të regjistruar, ky i fundit është përgjegjës për mbajtjen, deklarimin dhe pagesën e tatimit në burim për llogari të organit tatimor.
- ii. Kur qiramarrësi është një person i paregjistruar, si në rastin e turistëve vendas apo të huaj, ju si përfitues i të ardhurave jeni i detyruar të deklaroni dhe të paguani në organin tatimor, tatimin në burim jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

Nga sa interpretohet nga administrata tatimore, duke qenë që nuk gjendemi në rastin e përfitimit të të ardhurave nga turizmi por nga një subjekt i regjistruar, ky i fundit është përgjegjës për mbajtjen, deklarimin dhe pagesën e tatimit në burim për llogari të organit tatimor.

Me qarkoren sqaruese nr. 21824 prot., datë 26.10.2018 me lëndë: Për verifikimin, vlerësimin dhe llogaritjen e tatimit në burim për ambientet e dhëna me qera për qëllim të ushtrimit të aktivitetit tregtar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve cilëson se objekt i tatimit mbi qiranë (tatimi në burim) janë tatimpaguesit të cilët ushtrojnë aktivitet në ambientin e marrë me qira.

I njëjti qëndrim është reflektuar edhe në Vendimin nr. 6, datë 13.07.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili në dispozitivin e këtij vendimi, sqaron:

Kolegji, në analizë të parashikimeve ligjore të nenit 33, pika 1 e ligjit nr. 8438/199828 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, çmon se, referuar faktit se pala qiramarrëse ka qenë person juridik në kohën e ekzistencës së marrëdhënies dhe përfitimit të këtyre të ardhurave, ajo ka pasur edhe detyrimin për mbajtjen në burim të vlerës së tatimit mbi të ardhurat. Në këto rrethana, për sa kohë që detyrimi i përket një personi tjetër dhe jo subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka dyshime për ekzistencën/përfitimin e këtyre të ardhurave nga një burim i ligjshëm, ngarkimi me përgjegjësi i subjektit sipas ligjit nr. 84/2016, edhe në rast të mosshlyerjes së detyrimeve tatimore nga subjekte të tjera të së drejtës, nuk duket se vjen në harmoi me qëllimin dhe kërkesat e ligjit, i cili konsideron të ardhura të ligjshme ato të deklaruara dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, kur këto detyrime i takojnë subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur apo të tjerë të lidhur me të.

- Në mënyrë të përmbledhur referuar akteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga kandidatja, rezulton se midis bashkëshortit të saj dhe personit fizik tregtar Bujar Roçaj,

¹ <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1019/administrata-tatimore-qytetareve-qe-leshojne-prona-me-qira-njihni-ligjin>

është lidhur kontrata e qirasë në datë 12.04.2000, me vlerë të qirasë mujore 25.000 mijë lekë, me objekt dhënie në përdorim të dyqanit me qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar. Ndërkohë, ka rezultuar se nga ana e qiramarrësit nuk është deklaruar pranë organeve tatimore vlera e qirasë sipas përcaktimit të bërë në kontratë e për pasojë, nga ana e tij janë paguar detyrime tatimore të qirasë më pak, pra jo në përputhje me vlerën reale të saj.

19. Si më sipër, ILDKPKI ka konstatuar se ka pasaktësi midis deklarimit të bërë nga ana e subjektit të kontrollit, kandidates Elida Grabovari referuar vlerës së qirasë dhe deklarimit të bërë nga subjekti tregtar pranë organeve tatimore.

20. Në analizë referuar konstatimeve të ILDKPKI, shpjegimeve të kandidates sa më sipër, Relatori ka theksuar faktin, se Këshilli është i vetmi autoritet kushtetues dhe ligjor i ngarkuar nga Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të vlerësuar në thelb të dhënat e pasqyruara nga organin që ofron ndihmën administrative (ILDKPKI) argumentojë si vijon:

Nëse Këshilli si organ kushtetues dhe ligjor nuk do të ishte në gjendje të kryente një gjykim mbi ligjshmërinë e gjetjeve të evidentuara në raportet përkatëse të organeve, jo vetëm që do të cenohej autoriteti kushtetues i këtij organi, por edhe e drejta e individit për t'ju drejtuar gjykatës do të rezultonte si një e drejtë jo efektive.

21. Raporti i përpiluar nga ILDKPKI, si pjesë e një procedure ligjore, në kuadrin e një hetimi administrative **nuk është një akt përfundimtar** dhe si i tillë, nuk mund të jetë objekt kundërshtimi me padi në juridiksionin gjyqësor administrativ. Ky raport nuk është një akt administrativ, në kuptim të nenit 2, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, për arsye se ai nuk sjell drejtë-përdrejtë pasoja juridike konkrete ndaj paditësit, nuk përbën një sanksion, apo nuk mohon një të drejtë të caktuar të tij, por në kuadrin e një hetimi administrativ dhe sipas nenit 71, të Kodit të Procedurave Administrative, është "**ndihmë administrative**", që përmbushet nga organi i ngarkuar me ligj për kryerjen e një apo disa veprimeve të nevojshme, në kuadër të një procedure administrative."

22. Në këtë kuptim, kompetenca e ILDKPKI-së është të verifikojë dhe të hetojë në mënyrë të specializuar pasurinë e subjekteve dhe burimin e krijimit të saj. Në përfundim, ILDKPKI rezultatin e verifikimit dhe të hetimit ia paraqet Këshillit. Është ky i fundit, organi kompetent për të vlerësuar nëse **rezultatet e ILDKPKI-së janë të sakta apo të plota**. Pra akti përfundimtar i ILDKPKI-së nuk përcakton vendimin e Këshillit për këtë subjekt.

23. Pika 4 dhe 4/1 e nenit 32 të ligjit për Statusin, pas ndryshimeve, parashikojnë:

4. Në çdo rast **Këshillat çmojnë, sipas bindjes së tyre, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.**

4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur:

a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit;

24. Pra sikurse shohim legjislatori ka parashikuar 4 raste ku Këshilli mund të vendosë se kandidati nuk e kalon procesin e verifikimit të pasurisë:

- i. Kur burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij;**
- ii. Kur kandidati nuk ka deklaruar pasuri apo asete duke i fshehur ato;**
- iii. Kur kandidati në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;**
- iv. Kur kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit.**

25. Për të qenë në kushtet e parashikuara nga germa “a”, pika 4/1 e nenit 32 të Ligjit për Statusin duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative dy kushte, në radhë të parë deklarimi i kandidatit duhet të jetë i pasaktë dhe njëkohësisht, ky deklarim i pasaktë duhet të jetë bërë në mënyrë të qëllimshme nga ana e subjektit.

26. Duke bërë krahasimin midis gjetjeve të ILDKPKI-se të pasqyruara në Aktin Përfundimtar të Kontrollit të Plotë të Deklaratave të Interesave Private të subjektit Elida Grabovari dhe me kriteret ligjore të mësipërme të parashikuara në pikën 4 dhe 4/1, të nenit 32, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve”, rezulton se problemet e adresuara nga ILDKPKI për këtë subjekt kanë të bëjnë vetëm me mosplotësim të kriterit (**Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin**), ndërsa për kriteret e tjera ILDKPKI ka konkluduar se kandidatja Elida Grabovari ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

27. Ky fakt nuk përbën deklarim të pasaktë nga ana e kandidates, pasi veprimi juridik i lidhur midis palëve është i qartë në vlerën që ka përcaktuar masën e qerasë.

28. Fakti që personi fizik tregtar nuk ka përmbushur detyrimet tatimore duke mos deklaruar saktë detyrimet që rrjedhin nga qiraja, nuk përbën pasaktësi për subjektin, i cili nga ana e tij ka deklaruar pranë ILDKPKI-së konform kontratës, pasi ka qenë detyrim ligjor i qiramarrësit të përmbushte detyrimet tatimore sipas vlerës së qerasë të parashikuar në kontratë.

29. Në kushtet kur subjekt i kontrollit nuk është përgjegjës për deklarimin, mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim (tatimit mbi qiranë) për llogari të organit tatimor, por kjo përgjegjësi sa më sipër ka qenë e subjektit që ushtronte aktivitet tregtar, vlerësoj se të ardhurat e deklaruara janë ligjore, vijnë nga burime të ligjshme dhe të sakta në përputhje me ligjin.

30. Rezulton e provuar, se për kandidaten Elida Grabovari nuk ekziston asnjë nga rastet e përmendura në pikën 4/1 të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe për pasojë konsiderohet se e kalon me sukses procedurën e verifikimit të pasurisë.

Ky Akt Kontrolli përfshin periudhën deri në datë 29.06.2022.

31. Në datë 08.03.2025, Elida Grabovari ka dorëzuar pranë ILDKPKI, Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidates për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë/ **që kandidon për t’u emëruar Magjistrate, profili Prokuror.**
32. Për kryerjen e kontrollit të plotë të kësaj deklarate, ILDKPKI ka krahasuar Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidates për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jo-bankar, të dorëzuar nga vetë kandidatja, me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës së tyre, me nr.98 prot., datë 12.03.2025, pranë institucioneve të ndryshme. **Ky kontroll është kryer për periudhën 29.06.2022-08.03.2025.**
33. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është konstatuar, se për kandidaten Elida Grabovari:
- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
34. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Agjencia e Inteligjencës Financiare me shkresën e datës 09.04.2025, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë informon, se: ***“Pas kërkimeve në sistemin elektronik, për kandidaten Elida Grabovari nuk disponohen raportime.”***
35. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën Nr. 4476/1 prot., datë 25.03.2025, ka kthyer përgjigje se: **Shtetasja Elida Grabovari nuk figuron e regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.**
36. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën Nr.5375/1, datë 21.03.2025 ka informuar, se: Nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik të administrimit të të dhënave “Asycuda World” **rezulton, se shtetasja Elida Grabovari nuk ka kryer asnjë procedurë doganore.**

Sa lidhet me informacionin për para CASH, çek apo metale a sende të çmuara në pikat e kalimit kufitar doganor, nuk rezulton të ketë kryer veprime të tilla, për periudhën Mars 2004 Mars 2025.

37. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën Nr. 3543/1 prot., datë 25.05.2025 të ISSH, është dërguar informacion më të dhënat e nxjerra nga sistemi informatikë i ISSH, i cili disponon të dhëna për kontributet, të cilat mbledhen dhe dërgohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Web-service, sipas formularit bashkëlidhur të dërguar. Sipas këtij formulari rezulton, se: **“Për shtetasen Elida Grabovari janë paguar rregullisht pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, nga viti 2012 deri më tetor 2022”**.
38. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Qendra Kombëtare e Biznesit me shkresën Nr. 5552/1 prot., datë 20.03.2025 ka informuar, se: **“Shtetasja Elida Grabovari nuk rezulton të jetë pajisur me NUIS (NIPT), si person fizik, juridik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare, të regjistruara pranë Regjistrit Tregtar.”**
39. *Nga përgjigjet e ardhura nga këto institucione arrijmë në përfundimin, se: ka rezultuar përputhshmëri mes deklarimeve të kandidatës të kontrolluar, Aktit të përgatitur nga ILDKPKI-ja, si dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet e mësipërme. Në këtë mënyrë është konkluduar, se nuk ka nevojë të kryhet një hetim më i thelluar, se ai i kryer nga ILDKPKI.*

B. VERIFIKIMI I FIGURËS SË KANDIDATES

40. Mbi bazën e Formularit të vetë-deklarimit për zbatimin e Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kandidatja Elida Grabovari deklaroi se:

- nuk ka qenë e dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;
- nuk është e dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo-përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- nuk ka qenë ndonjëherë nën hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale;
- nuk ka qenë e ndaluar apo arrestuar nga organet ligj-zbatuese, për kryerjen e një vepre penale;
- nuk është caktuar ndaj saj ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo;
- nuk është lëshuar ndonjëherë ndaj saj një urdhër kërkimi ndërkombëtar, lidhur me kryerjen e veprave penale;
- nuk është marrë ndaj saj masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- nuk ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 (një) muaj.

41. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën Nr. 429/3, datë 27.03.2025, Prokuroria e Përgjithshme informon si më poshtë:

Nga verifikimet në Sekretarinë Sekrete në zyrën e arkiv protokollit në Prokurorinë e Përgjithshme rezultoi, se: **Nga verifikimet ne sektorin e Burimeve Njerëzore, Marrëdhëniet me Publikun dhe Arkivit Sekret, rezultoi se nuk ka çështje penale, kallëzim apo ankesë ndaj saj.**

42. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me shkresën Nr.10167, datë 25.03.2025, informon, se: **Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të kësaj prokurorie, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të shtetases Elida Grabovari, nga data 30.06.2022 deri aktualisht.**
43. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm: Berat, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, Elbasan, informojnë, se: **“Për shtetasen Elida Grabovari nuk disponojnë të dhëna, apo indicie të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese, të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm apo materiale kallëzuese të mos-filluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim”.**
44. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën Nr. 1119, datë 01.04.2025, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konfirmon se pas verifikimeve të kryera në regjistrat përkatës nga sekretaria gjyqësore, **rezulton se në lidhje me shtetasen Elida Grabovari nuk rezulton të ketë proces gjyqësor penal pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe kjo gjykatë nuk ka dhënë vendim penal për këtë kandidaten.**
45. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën Nr. 497/1 datë 18.03.2025, konfirmon se pas verifikimeve të kryera në regjistrat që disponojnë, në lidhje me shtetasen **Elida Grabovari, nuk rezulton të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal. Ndaj saj nuk është marrë vendim për të zbatuar/revokuar/shuar një masë sigurimi me karakter personal ose pasuror. Nuk ka të dhëna për procedime penale të mos-filluara, të pushuara apo të pezulluara, vendime dënime apo pafajësie në të cilat përmendet emri i kandidates në proces verifikimi.**
46. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me shkresën Nr. 6062/1 datë 19.03.2025 informon, se pas verifikimeve të kryera në **Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) në lidhje me shtetasen Elida Grabovari, nuk rezulton të ketë pasur apo të ketë çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershëm.**
47. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykatat pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm; Berat, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, Elbasan, informojnë, se **për shtetasen Elida Grabovari nuk rezulton të ketë pasur apo të ketë në ngarkim të saj çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershëm.**

Raportimi nga organet e specializuara

48. Gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidaten Elida Grabovari iu kërkuar informacion shërbimeve informative shtetërore, si Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

49. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kanë kthyer përgjigje me shkresat përkatëse të klasifikuara, ku është konstatuar se gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidaten Elida Grabovari:

- *Nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme;*
- *Nuk ka të dhëna për veprimtari kriminale apo të ketë lidhje/kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;*
- *Nuk disponohen të dhëna/informacione për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.*

50. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me Shkresën nr. 2279 prot, datë 25.04.2025, ka informuar, se: **“nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e znj. Elida Grabovari në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme”.**

51. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Byroja Kombëtare e Hetimit me shkresën Nr. 440/1 prot, datë 28.03.2025, ka informuar, se: **“Nuk disponohen informacion dhe të dhëna për kandidaten Elida Grabovari”.**

52. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Shkolla e Magjistraturës me shkresën Nr. 426/1 prot., datë 21.03.2025, informon se: **“Kandidatja Elida Grabovari nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe ndaj saj nuk ka ndonjë proces disiplinor”.**

53. Për shkak të datëlindjes së kandidates, Këshilli nuk i është drejtuar me shkresë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi kandidatja nuk është subjekt verifikimi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

54. Referuar Deklaratës, datë 25.02.2025, mbi papajtueshmërinë me funksionin e magjistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike, kandidatja Elida Grabovari ka deklaruar se: nuk është anëtare në ndonjë parti politike, pasi kjo përbën shkak papajtueshmërie me funksionin e magjistratit. Kjo deklaratë është lëshuar me përgjegjësi ligjore sipas nenit 6, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sipas Deklaratës Individuale datë 25.02.2025, kandidatja ka deklaruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk është bashkëpunëtoare, informatore ose agente e shërbimeve sekrete.

55. Përsa më sipër, Këshilli vlerëson të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidates për magjistrat prokuror, e cila është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024-2025, znj. Elida Grabovari.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës, në nenet 32 dhe 35, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në nenet 159 dhe 189 pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në Vendimin nr. 171, datë 29.09.2019, "Për miratimin e "Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale sipas Relacionit nr. 1938, datë 09.07.2025, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidates për magjistrat prokuror, e cila është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024-2025, znj. Elida Grabovari.
2. Lejimin e kandidates Elida Grabovari, të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si prokuror.
3. Të njoftohet për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës dhe znj. Elida Grabovari.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 16.07.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla